

Projekti CARDS 2005 « Per ngritjen e Autoritetit Kombetar te Ushqimit »

Fondi : 3 million €

Objektivat kryesore te Projektit CADRS 2005 çojne ne permiresimin e Mbrojtjes se Konsumatorit ne Shqiperi, mbeshtetur nga nje sistem eficient, i konsoliduar dhe i ristrukturuar per sigurine ushqimore, nepermjet:

- Ngritjes se Autoritetit Kombetar te Ushqimit
- Kuadrit Ligjor ne fushen e Ushqimit
- Politikave te Ushqimit

Objektivat e pergjithshme: permiresimi i mbrojtjes se konsumatorit ne vend mbeshtetur nga nje sistem eficient dhe i konsoliduar i sigurise ushqimore.

Qellimi i ketij projekti :

Mbeshtetur ne ligjin e ushqimit, i cili eshte ne te njejten linje me legjislacionin e BE-së, AKU ngrihet si nje strukture e pavarur, e afte te siguroje traspozimin e legjislacionit te BE-se ne fushen e sigurise ushqimore, te krijoj nje politike te sigurise ushqimore e pranuar nga te gjitha grupet e interesit dhe gjithashtu t'ju ofroje atyre nje komunikim adekuat ne lidhje me sigurine ushqimore.

Rezultatet e projektit :

- AKU eshte ngritur si nje strukture e pavarur, eficiente dhe e qendrueshme, e afte te implementoje legjislacionin kombetar dhe ate European, ne lidhje me sigurine ushqimore dhe çeshtjet e kontrollit.
- Ligji i ri i Ushqimit eshte amenduar ne te njejten linje me legjislacionin e BE-së dhe mbeshtetur nga te gjithe faktoret e nevojshem per implementimin e tij.
- Nje politike te qarte te sigurimit ushqimor dizenjuar dhe pranuar nga te gjitha grupet e interesit.
- Nje sistem inspektimi te ristrukturuar, eficient dhe efektive, me detyra te qarta dhe pergjegjesi te ngritura nepermjet politikave te qarta te sigurise ushqimore.
- Kompozim te struktures te perfshire ne ceshtje te sigurise ushqimore ne lidhje me traspozimit e acquis eshte perforcuar nepermjet nje politike te qarte te sigurise ushqimore.
- Pikat e kontrollit kufitar per veterinarine dhe fitosanitaret eshte sjelle ne te njejten linje me regullat e BE-se.

- Konfliktet e brendshme institucionale ndermjet institucioneve te cilat jane te perfshira ne ceshtje e kontrollit dhe inspektimit ushqimor, jane qartesuar duke perfshire zbatimin e parimit - nje nderrmarrje - nje inspektor. Gjithashtu jane ngritur marredhenie funksionale ndermjet AKU-se dhe Ministrive ne lidhje me ceshtjet e sigurise ushqimore.
- Niveli i sigurise ushqimore ne vend eshte permiresuar duke zhvilluar komunikimin dhe pjesmarrjen proaktive, kooperuese te te gjithe grupeve te interesit, duke perfshire ketu institucione, operatoret e biznesit per ushqimin dhe konsumatoret. Dhe e gjitha kjo nga nje ngritje institucionale deri te zbatimi ne praktike te rregullave ne lidhje me sigurine ushqimore. Nje kujdes i vecante i eshte kushtuar sigurise per produktet me origjine shtatzore: mishit, qumeshtit, peshkut, vezeve etj. Por gjithashtu, ky kujdes eshte parashikuar edhe per ushqimin e kafsheve i cili te jete ne te njejtin linje me kerkesat e BE-se.
- Kapaciteti i inspektimit dhe rrjeti laboratorik ne nivel rajonal dhe qendror eshte permiresuar duke ju siguruar atyre njohuri teknike qe perfshijne mjete specifike dhe pajisje dhe duke shmangur shkarkimet nga puna te stafit te kualifikuar.
- Nje sistem alert qe ka te bej me ushqimin dhe ushqimin e kafsheve eshte vendosur ne funksionim, ne lidhje me kapacitetin e veprimit te rapid alertit per situata emergjente. Eshte ngritur nje kapacitet monitorimi ne lidhje me ceshtje te sigurise ushqimore dhe krijimi i nje data base operacional.
- Kapaciteti gjurmeshmerise se produkteve nepermjet gjithe zinxhirit ushqimor ka filluar dhe eshte aplikuar ne produktet e indentifikuar, ne bashkepunim me projektet e tjera.

Fazat e ngritjes se AKU-se:

-ngritja dhe funksionimi i AKU-se eshte miratuar me VKM nr.1081 "Per organizimin dhe funksionimin e AKU-se" ne 21 tetor 2009, (Gazeta zyrtare nr. 164, date 13. 11. 2009), ku percaktohen qarte se AKU do te behet operacional ne 3 faza brenda 2 viteve (2010 – 2011). Ne kete autoritet do te perfshihen inspektimet e 3 fushave: siguri ushqimore, shendet kafshesh, mbrojtje bimesh.

AKU varet nga MBUMK dhe ka seline qendrore ne Tirane, si dhe 12 zyra rajonale (zyra kontrolli). Ne perberje te AKU-se eshte Komiteti Shkencor dhe Bordi i Drejtimit.

Brenda vitit 2010 te gjithe funksionet ne lidhje me kontrollin ne fushen e sigurise ushqimore te mbuluara nga MBUMK, Ministria e Shendetesise dhe Bashkite do te transferohen nen AKU.

Deri ne fund te vitit 2011 i tere procesi i organizimit dhe funksionimit te AKU-së do te perfundoje me kalimin e Inspektoriatit te Shendetit te Kafsheve (ISHK) dhe Inspektoriatit te Mbrojtjes se Bimeve (IMB) nen kete autoritet.

VKM sanksionon ngritjen e AKU-së ne fazat si me poshte:

Faza e parë përfshin periudhën nga muaji 1 deri në 4. Gjatë kësaj faze kryhet emërimi i Drejtorit të Përgjithshëm dhe Bordit, si dhe rekrutimi i punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së. Gjithashtu përgatitet plani i veprimit dhe krijimi i kushteve për ngritjen dhe funksionimin e drejtorive rajonale të AKU-së.

Faza e dytë përfshin periudhën nga muaji 5 deri 12. Gjatë kësaj faze emërohen drejtorët e drejtorive rajonale të AKU-së, rekrutohen punonjësit e tyre, si dhe sigurohen ambjentet e nevojshme të punës. Deri në përfundim të kësaj faze, të gjitha drejtoritë rajonale përgatiten për fillimin e veprimtarisë së tyre në fushën e kontrollit të ushqimit dhe të ushqimit për kafshë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, nëpërmjet strukturave përkatëse, krahas detyrave të saj të përhershme për përgatitjen e legjislacionit, hartimin e politikave dhe menaxhimin e riskut, do të vazhdojë të ushtrojë së bashku me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Bashkite, të gjitha funksionet në fushën e sigurisë ushqimore, përfshirë edhe inspektimet, deri në plotësimin e masave të parashikuara për fazën e parë dhe të dytë.

Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, me urdhër, njofton fillimin e veprimtarisë së AKU-së, në nivel qendror dhe rajonal në fushën e kontrollit të ushqimit dhe ushqimit për kafshë. Pas këtij njoftimi, funksionet në fushën e kontrollit të ushqimit dhe ushqimit për kafshë, të kryera nga strukturat përkatëse të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministrisë së Shëndetësisë, si dhe të Bashkive, i transferohen AKU-së.